

RAPORT HIDROGJEOLOGJIK MBI RRUGËN SHESHAJ

Resurset ujore

Raporti i resurseve ujore dhe harta hidrogjeologjike paraqet në mënyrë të qartë, gjithë informacionin hidrogjeologjik lidhur me resurset ujore të Bashkisë Mirditë dhe përbën një dokument shumë të rëndësishëm për menaxhimin e integruar të resurseve ujore nëntokësore nga organet menaxhuese dhe përdoruese të ujit.

Bashkia ka resurse ujore të mëdha të cilat janë të lidhura kryesisht me akuiferët karbonatik dhe më pak me ato magmatikë, ndërkokrrizorë apo aluvialë si: Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor me ujëpërcjellshmëri mesatare deri shumë të lartë dhe akuiferët me porozitet ndërkokrrizorë me përhapje të kufizuar dhe ujëpërcjellshmëri mesatare - të ulët. I pari lidhet me depozitimet Kuaternare (Qh2, Qh) dhe përfaqësohen nga zhavore, rëra, alevrite dhe argjila që lidhen me depozitimet e Lumit Fan që nga derdhja në Lumin Mat deri në Rrëshen. Ato zënë një sipërfaqe prej 11.57 km². I dyti përfaqësohet nga deluvione, aluvione,

proluvione, rëra, zhure, zhavore etj (gropat malore). Ato zënë një sipërfaqe prej 0.35 km² dhe shtrihen në Bardhaj, Lëkundaj, Arrëz, Lurth, Bukmirë, Bisakë, Lajthizë, Reja e Velës etj. Pastaj kemi akuiferë me porozitet çarje - karst me përhapje të gjërë dhe ujëpërshkueshmëri shumë të ndryshueshme, vende - vende shumë e lartë që kanë përhapje të gjërë në Bashkinë e Mirditës, me një sipërfaqe që varion në rreth 150 km². Përfaqësohen kryesisht nga gëlqerorë shtresë trashë deri masivë etj.dhe përhapen në Prroi I Kumbullës, Nënshajt, Lami i Madh, Lufaj, Munellë, Shëngjin, Rrasfik etj. Më tej kemi akuifer me porozitet

poro - çarje me përhapje të gjërë dhe ujëmbajtje të ulët deri në shumë të ulët që kanë një sipërfaqe prej 146.6 km² dhe përfaqësohen nga gëlqerorë dhe silicorë radiolaritikë. Përhapen në Zhur, Simon, Rubik, Katundi i Vjetër etj. Akuifer tjetër me përhapje të gjërë është akuiferi me porozitet çarjesh me ujëpërshkueshmëri mesatare - të ulët i cili përfaqësohet nga: Shkëmbinj metamorfikë (amfibolite, paragnejse, rreshpe kuarcore,

andezite etj), shkëmbinj vullkanikë (bazalte, andezite etj), shkëmbinj bazikë (gabro, gabro-diabaze, norite, troktolite etj) dhe shkëmbinj ultrabazikë (serpentinite, dunite, harcburgite etj). Kanë një sipërfaqe prej 425.4 km² dhe shtrihen në: Thirrë, Hebe, Xhuxhë, Shengjin, Konaj, Reps, Mashterkorë, Grykë-Spaç, Simon, Kaçinar, Shëngjergj, Bukmirë, Lurth etj. Përveç akuiferëve në territorin e Bashkisë Mirditë kemi edhe jo akuiferë të cilët kanë porozitet të pa

mjaftueshëm për të lejuar qarkullimin e ujërave nëntokësorë në sasi të shfrytëzueshme dhe përfaqësohen nga flishe alevrolito – ranore - argjilore, konglomerate, konglobrekçe, 5melanzhi “Mirdita” etj. Kanë sipërfaqe prej 135.8 km². Përhapen në: Rrasfik, Katund i Vjetër, Rrëshen, Perlat, Ujëstretzë, **Sheshaj**, Blinisht, Malaj, Tenë, Shebë e Bulshizë. Rruga Sheshaj ndodhet në **BASENIN UJOR MAT**.




Fig. 1 Harta e shtrirjes së projektit, BI - ASIG

SHPJEGUESI

Njësitë hidrogeologjike

Akullferë

Me porozitet ndërkorrizor

-  Akullfer me përhapje të gjerë dhe ujëmbajtje shumë të lartë deri mesatare. (rëra-zhavorë, rëra-zhavorë-sievrite)
-  Akullfer me përhapje të kufizuar dhe ujëmbajtje mesatare deri në shumë të ulët. (argjila + rëra + sievrite + zhavorë)

Me porozitet çarje - karst

-  Akullfer me përhapje të gjerë dhe ujëmbajtje tepër të ndryshueshme, vende-vende deri në shumë të lartë. (gëlqeror, dolomite)

Me porozitet poro - çarje

-  Akullfer me përhapje të kufizuar dhe ujëmbajtje lokale të ulët deri shumë të ulët. (ranorë + sievrite)

Me porozitet çarje

-  Akullfer me përhapje të gjerë dhe ujëmbajtje të ndryshueshme, mesatare deri në shumë të ulët

Praktikisht jo akullfer

-  Shkëmbin praktikisht pa rezerva ujërash nëntokësore (argjila, fish, evaporite)

Litologjia

Shkëmbinjtë të shkriftët

Sedimente

-  Rëra, zhavorë, argjila
-  Argjila, rëra, zhavorë
-  Argjila, sievrite, rëra

Shkëmbinjtë kompakt

Shkëmbinjtë Sedimentar

-  Argjila, ranorë, konglomerate
-  Ranorë, mergele, konglomerate, argjila dhe material i ndryshëm copëzoz
-  Fish
-  Gëlqerorë

Shkëmbinjtë Magmatik dhe Metamorfik

-  Shkëmbinjtë ultrabazikë
-  Shkëmbinjtë bazikë
-  Shkëmbinjtë vulkanite

Fig. 3 Legjenda mbi hartën hidrogeologjike

Pwrgatiti:

Ing. Ersida VERÇANI